EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

Legal summary prepared for HUDOC by © Consulate General of the Republic of Kosovo in Strasbourg.

Përmbledhje juridike e përgatitur për HUDOC nga © Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Kosovës në Strasburg.

September/Shtator 2026

Kiguradze k. Gjeorgjisë – *25784/23*
Aktgjykim i datës 23.06.2026

Neni 6 (aspekti civil)

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës *(e drejta e qasjes në gjykatë)*

Nuk përbën shkelje të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës mos shqyrtimi në themel i padisë për shpifje të ankuesit kundër një deputeti për shkak të imunitetit parlamentar të këtij të fundit.

Fjalët kyçe të rastit

Neni 6 §1 (aspekti civil) – e drejta e qasjes në gjykatë – përfundimi i procedurave të ankuesit për shpifje kundër një deputeti – imuniteti parlamentar – mbrojtja e deklaratave të bëra në ushtrimin e funksioneve parlamentare – mungesë e kufizimit disproporcional të së drejtës së qasjes në gjykatë – ndërhyrje me bazë të qartë ligjore – qëllim legjitim për garantimin e lirisë së shprehjes së përfaqësuesve të popullit – ruajtja e ndarjes së pushteteve ndërmjet pushtetit legjislativ dhe gjyqësorit – imuniteti parlamentar nuk përbën në parim një kufizim disproporcional të së drejtës së qasjes në gjykatë – zbatimi i rregullit të imunitetit parlamentar nga gjykatat vendore nuk është automatik – ekzistenca e një lidhjeje të qartë ndërmjet deklaratës së deputetit dhe funksioneve të tij parlamentare – verifikimi i duhur i kësaj lidhjeje nga gjykatat vendore – hapësirë e gjerë vlerësimi.

Faktet

Ankuesi është një sipërmarrës. Ai është gjithashtu anëtar i Akademisë Gjeorgjiane të Energjisë dhe autor librash.

Në vitin 2011 ai u dënua me nëntë vjet burg për spiunazh.

Ne vitin 2012 ankuesi dhe disa individë të tjerë fituan statusin e të burgosurve politik përmes një dekreti të Parlamentit. Më pas ankuesi u lirua nga burgu në bazë të një amnisitie penale.

Me kërkesën e tij, vendimi penal i fajësisë u rishikua dhe ai u shpall i pafajshëm.

Në një datë të papërcaktuar në vitin 2020, disa portale raportuan se një numër kompanish dhe sipërmarrësish kishin dhuruar rreth 580,000 EUR për partinë në pushtet "Ëndrra Gjeorgjiane" gjatë tremujorit të parë të vitit. Si pjesë e atij mbulimi mediatik, u raportua

se ankuesi kishte dhuruar përafërsisht 14,500 EUR. Portalet dhe disa politikanë të opozitës vunë në dyshim arsyet e vërteta të dhurimeve nga ankuesi dhe kontribuesit e tjerë.

Në këtë konktekst, një deputet, I.A., u intervistua shkurtimisht, me sa duket brenda ndërtesës së Parlamentit. Pas pretendimeve se korrupsioni po dëmtonte klimën e investimeve ne vend, ai dha edhe deklaratën vijuese:

> "*Sa u përket individëve konkretë [përfshirë ankuesin] dhe qëndrimit të [partisë] Ëndrra Gjeorgjiane ndaj spiunëve për Rusinë, po, jo vetëm Kiguradze [ankuesi], por edhe individë të tjerë që më parë ishin dënuar për spiunazh u liruan [nga burgu] nga Ëndrra Gjeorgjiane si të burgosur politikë, [dhe partia në pushtet] nuk ka zbuluar asnjë spiun që nga ajo kohë. Pra, këta njerëz janë partnerët politikë të Ëndrrës Gjeorgjiane...*"

Vendimet e gjykatave vendore

Në vitin 2020 ankuesi paditi për shpifje deputetin dhe disa media që kishin transmetuar deklaratën. Deputeti u mbrojt duke theksuar imunitetin e tij parlamentar për deklarata politike.

Në vitin 2021 gjykata themelore e Tbilisit përmes një vendimi të ndërmjetëm e veçoi dhe pushoi çështjen kundër deputetit. Ajo gjykatë konsideroi se deklarata e deputetit ishte një përzierje pretendimesh faktike dhe opinionesh. Duke u mbeshtetur në ligjet e zbatueshme dhe jurisprudencën e Gjykate Supreme, ajo gjykatë gjeti gjithashtu se deklarata ishte e natyrës politike dhe nuk mund të sillte përgjegjësi për shpifje sipas ligjit vendas i cili parashikonte imunitetin e deputetëve në raste të tilla. Deklarata ishte bërë në kontekstin e miratimit të dekretit parlamentar për listën e dënuarve politike.

Ankuesi e kundërshtoi këtë vendim duke theksuar se dënimi i tij penal për spiunazh ishte anuluar dhe portretizimi i tij si individ i dënuar përbënte shpifje. Megjithatë, në vitin 2023 Gjykata e Apelit e Tbilisit (shkalla e dytë dhe e fundit) konfirmoi vendimin e kundërshtuar me të njëjtin arsyetim që kishte përdorur edhe gjykata e shkallës së parë.

Në po atë vit, 2023, ankuesi dorëzoi një ankesë në GJEDNJ duke pretenduar se mos shqyrtimi i themelit të padisë së tij kundër deputetit për shkak të imunitetit të këtij të fundit përbente një kufizim shpërpjesëtimor të së drejtës së ankuesit për t'iu drejtuar gjykatës (pra, kufizim të qasjes në gjykatë).

Arsyjetimi juridik i GJEDNJ

1. Gjykatat vendase nuk e zbatuan në mënyrë automatike imunitetin parlamentar, përkundrazi ato morën në konsideratë argumentet konkrete të palëve dhe rrethanat konkrete të rastit përpara se arrinin në përfundimin që arritën.

2. Konkretisht gjykatat vendase peshuan jo vetëm përmbajtjen e deklaratave të deputetit por edhe kontekstin e tyre, dekretin e parlamentit për t'u njohur disa individëve statusin e të burgosurve politikë, ligjin dhe jurisprudencën e zbatueshme.

3. Gjykatat vendase u siguruan që ekzistonte një lidhje e qartë mes deklaratave të deputetit dhe ushtrimit të funksionit të tij parlamentar.

4. Në këtë kontekst, duke pasur parasysh hapsirën e gjerë të vlerësimit që gëzojnë Shtetet anëtare në formulimin e rregullave të imunitetit parlamentar, GJEDNJ konsideroi se kufizimi konkret i të drejtës së ankuesit për t'iu drejtuar gjykatës,

pra kufizimi i qasjes në gjykatë, nuk ishte në tejkalim të hapësirës së vlerësimit në fjalë.

Përfundimi: nuk ka shkelje të së drejtës së ankuesit për t'iu drejtuar gjykatës sipas nenit 6§1 të Konventës.

Shënim: *Aktgjykimi i plotë i GJEDNJ është më i detajuar dhe nuancuar; kjo përmbledhje ligjore përmban vetëm elementet thelbësore të fakteve, arsyjetimit dhe përfundimet kyçe të GJEDNJ.*